



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria për Prokurim Publik – Vushtrri

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë : “ El – Bau “ sh.p.k. me seli në Gjilan, Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjekt në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **21.06.2023**, merr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazë Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin në procedurë: “ El – Bau “sh.p.k.” me seli në Gjilan , në procedurën prokurimit me titull: “ Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal “ , Nr.i prokurimit: VU644-22-8873- 2-2-1 & Nr. i brendshëm: VU644-22-114-221.
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues - Drejtorisë për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 06.06.2023.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që të rekomandoi anulimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë, pasi që për këtë aktivitet të prokurimit, për të cilin janë hapur ofertat nga data 21.09.2022, dhe si rrjedhojë kanë kaluar shumë muaj, ka skaduar kohëzgjatja e vlefshmërisë së ofertave bazuar në afatin e saktësuar në Njoftimin për Kontratë në nenin IV 3.3 dhe nenin IV.5 të Dosjes së Tenderit.

Po ashtu, duke qenë se aktiviteti i prokurimit është iniciuar në vitin 2022 dhe mjetet financiare të parapara për këtë projekt, në pamundësi të përmbylljes së aktivitetit të prokurimit në vitin fiskal 2022, kanë kaluar në Buxhetin e Kosovës, Njësia Kërkuese e A.K. – Drejtoria për Shërbime Publike , përmes shkresës – Kërkesës të dt. 29.05.2023 ka kërkuar nga Drejtori e Prokurimit që, meqenëse në këtë vit fiskal, 2023, edhe përkundër angazhimeve deri më sot nuk ka arritur të siguroi mjetet financiare për përfundimin e këtij aktiviteti respektivisht projekti në mungesë të sigurimit të mjeteve dhe përbushjes së funksionit të Njesisë Kërkuese ashtu sikurse është rregulluar me nenin 10 paragrafi 1 pika (a) , ky aktivitet të anulohet.

Bazuar në këto që u cekën më lartë, kam konkluduar se procedimi më tej me këtë aktivitet të prokurimit do të bie ndesh me dispozitat e nenit 30 paragrafi 30.4 të Rregullores nr. 001/22 për Prokurimin Publik, më tej (RrPP) pasi që procesi i vlerësimit nuk është finalizuar brenda afatit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, ndërsa që zgjatja e vlefshmërisë së tenderit duhet të kërkohet vetëm para datës së skadimit të vlefshmërisë së tenderit, dhe po ashtu me nenin 10 paragrafi 1 pika (a) të RrPP, për shkak se mjetet financiare për realizimin e projektit nuk janë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues.

Marrë parasysh këtë që u theksua më lartë në këtë Vendim, lidhja eventualisht e kontratës me O.E. do të përbënte shkelje të dispozitave ligjore, andaj, mbi këtë bazë kam vlerësuar se janë përbushur kushtet që në zbatim të nenin 62 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-se lidhur me nenin 43 paragrafi 43.5 pika (i) aktiviteti i prokurimit të anulohet për shkak se , citat : “ një

shkelje ligji ka ndodhë ose do të ndodhë dhe nuk mundë të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi “ mbarim citati.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për anulimin e aktivitetit të prokurimit janë dërguar për publikim në platformën elektronike me dt. 06.06.2023, bazuar në dispozitat e Rregullores për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 06.06.2023, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 1 – Qëllimi , nenin 9, nenin 59.1 dhe nenin 30 të Rrpp.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

Asnjë nga pretendimet e O.E. : “ El – Bau “sh.p.k. nuk qëndrojnë, pasi që të njëjtat nuk ka bazë ligjore, por janë të bazuara vetëm në vlerësime subjektive. AK ka marrë këtë vendim bazuar në elementin qenësor – thelbësor, mungesën e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të cilat eventualisht do të krijoheshin me nënshkrimin eventual të kontratës me OE. Ashtu sikurse është theksuar edhe më lartë, vazhdimi i mëtutjeshëm me këtë aktivitet të prokurimit, në mungesë të mjeteve financiare, natyrisht se do të përbënte shkelje ligjore, andaj sikurse ka vlerësuar autoriteti kontraktues, për të mos ndodhur një shkelje ligjore, dhe për të mos u dëmtuar si interesi i AK ashtu edhe interesi i OE, AK ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Udhëzim Juridik : Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në OSHP, në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-së lidhur me nenin 9 të Rregullave për parashtrimin e ankesës pran OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria për Prokurim Publik
K.R. nr. 114/2022 - datë: 21.06.2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtore i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj